


# KOSOVA VOTON



# MË 22 TETOR

# DEMOKRACIA, PËRFAQËSIM DHE PJESËMARRJE

ERIONA (10), SUELA (11), DJELLON (11), RIGON (11), HALIT (11), AURORA (10)



## Demokracia ua mundëson të gjithë qytetarëve të drejtën për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tyre, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë qoftë me anë të përfaqësuesve të zgjedhur

Demokracia është një formë e qeverisjes në të cilën pushteti shtetëror rrjedh nga populli. Fjala demokraci vjen nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje apo qeverisje. E me këtë kuptohet se demokracia është udhëheqje e popullit. Sa peshë të madhe ka fjala demokraci, besojmë se çdo qytetar e di.

Është ky sistem i qeverisjes, i cili na mundëson që të gjithë të trajtohem në mënyrë të barabartë, të gëzojmë mundësi të barabarta, por po ashtu edhe para ligjit të jemi të tillë. Përpos kësaj, demokracia neve na mundëson edhe pjesëmarrje. Si mund të arrihet kjo? Ne dijmë që ende nuk e gëzojmë të drejtën e votës, sepse me një farë forme kur voton je pjesë e vendim-marrjes. Mirëpo, ne kemi të drejtë të marrim iniciativa të ndryshme, ndikimi i të cilave mund të jetë shumë i madh.

Përveç këtyre që i cekëm për demokracinë, është edhe një element tjetër i cili e fuqizon edhe më shumë rëndësinë e demokracisë në jetërat tona: si respektimi i të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

Pa dyshim që demokracia është udhëheqje e shumicës, por është e pamundur të funksionojë si e tillë nëse nuk respektohen edhe të drejtat e këtyre komuniteteve. Qohen komunitete jo shumicë, të gjitha ato komunitete të cilat kanë numër të qytetarëve paksa

më të vogël se sa shumica. E kjo është demokracia, ku të gjithë qytetarët jetojnë në harmoni me njëri-tjetrin. Vendi ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese, sepse vendimet në emër të popullit i marrin deputetët. Ndërsa, ka disa vende që populli i merr vendimet aty për aty, e kjo njihet si demokraci e drejtpërdrejtë. Pasi që jemi tek demokracia e drejtpërdrejtë, mendojmë që është e drejtë t'iu tregojmë se demokracia ka lindur në Athinë, kryeqytetin e Greqisë. Shteti i parë demokratik ishte themeluar në Amerikë, kurse në Evropë ishte Franca. Nga kjo kuptojmë që demokracia për të arritur këtu ku është, iu është dashur vite e shekuj me radhë. Prandaj, duhet ta ruajmë dhe të kujdesemi për të, sepse demokracia është e shenjtë.



„Nocioni i demokracisë është se më i dobëti duhet të ketë shansin e njëjtë sikurse më i forti“ - Mahatma Gand

## POPULLI AKTIV

ENGJULL (12), ALIJETA (10), FLORETA (11), LEART (11), DIOLENT (11), ELIZA (11)

### E DREJTA E VOTIMIT



#### Mësojeni se si vepruam ne gjatë një vizite në Muzeun e Kosovës

Ishte një ditë e bukur pranvere. Bashkë me shokët e mi vendosëm të shkojmë në Muzeun e Kosovës. E dinim se në muze, do të shihnim objekte të ndryshme historike. Këto objekte janë shumë me vlerë për neve si qytetarë. Falë tyre, ne mund ta shohim nga afër historinë. Pasi shkuam brenda, mësuam gjithçka që gjendej brenda në muze.

Pak më tutje, kemi vërejtur dy persona të cilët tentonin të preknin objektet e Muzeut. Ne fare mirë e dijme se objektet nuk duhet prekur në muze. U afruam dhe u thamë: „të dashur shokë, këto objekte nuk duhet prekur“. Ata na shikuan çuditshëm dhe u interesuan pse ne i ruajmë objektet e Muzeut. Ne u përgjigjëm se: „qytetarët e mirë demokratik, ruajnë gjithçka të shtetit të tyre, sikur ta kishin pronë personale,“. Ata na shikuan për ca sekonda dhe u pajtuan me ne. Kërkuan falje

dhe na falenderuan që iu treguam se si sillen qytetarët e mirë në demokraci. Po ashtu, na premtuan se gjithmonë do ta mbanin në mend këshillën tonë. U ndamë shumë të lumtur dhe u përshëndetëm miqësisht.

Të nesërmen në shkollë e treguam ngjarjen dhe të gjithë ishin të lumtur me veprimin tonë.

Edhe ju të dashur lexues, mos harroni se në demokraci përgjegjësa jonë si qytetarë është të ruajmë pronat publike. Mirëpo, kemi edhe përgjegjësi të tjera si: respektimi i ligjit, mbrojtja e ambientit, etj. Mos i harroni as të drejtat tona. Këto të drejta janë: e drejta e votës, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e shkollimit, etj.

Gjithashtu, vendi ynë ka shumë nevojë edhe për angazhimin tonë. Kontributi ynë është i domosdoshëm. Për shembull, puna vullnetare është shumë e rëndësishme për të përmirësuar jetën në komunitet. Këtë mund ta bëjmë duke u organizuar për ta pastruar lagjen, shkollën, apo edhe qytetin ose fshatin ku jetojmë.



Gjatë punës në grup



Qytetarët aktiv në demokraci



**Qytetarët aktiv nuk mendojnë vetëm për veten. Ata marrin iniciativa që e përmirësojnë jetën në komunitet**



**Vota është vendimmarrëse dhe duhet të jetë objektive. Të gjithë të jemi aktiv duke votuar**



**Mendojmë se gazeta jonë do të ndihmojë shumë që edhe ju të kuptoni rëndësinë e demokracisë**



**Në këtë fotografi mund të shihni atmosferën e këndshme sot në „Demos-ti“**



**Asnjëherë nuk duhet të kufizojmë veten duke bërë dallime. Të gjithë jemi njerëz dhe të gjithë kemi të drejtat tona. Ta duam dhe ta respektojmë njëri-tjetrin, ashtu si edhe na ka hije**

# MENDIMET E QYTETARËVE PËR ZGJEDHJET

FJOLLA (11), VALDRIN (12), LORIK (11), VION (11), ERZA (10)

**Shpeshherë ne dëgjojmë në televizion për zgjedhjet. Por, a keni menduar ndonjëherë se çfarë janë ato? Për këtë arsye, ne kemi dalur sot në rrugët e qytetit të Prishtinës për t'i pyetur qytetarët se çfarë mendojnë ata për zgjedhjet. Nëse dëshironi të dini përgjigjet e tyre, vazhdoni të lexoni...**

Ne sot në Punëtorinë e Demokracisë filluam të diskutim për zgjedhjet. Ne mësuam për këtë temë dhe thamë se ky është procesi më demokratik që ne e kemi në Kosovë. Kemi dy lloje zgjedhjesh, zgjedhjet komunale apo lokale dhe zgjedhjet parlamentare apo qendrore. Por, cili është dallimi mes këtyre zgjedhjeve, mund të pyesni ju?

Dallimi është se zgjedhjet komunale organizohen që ta zgjedhim Asamblenë Komunale dhe Kryetarin e Komunës sonë. Për shembull, ne jetojmë në Komunën e Vitisë, prandaj personat që zgjedhen për të punuar në Asamblenë tonë dhe Kryetari i Vitisë, janë që të gjithë qytetarë të komunës sonë. Kurse, në zgjedhjet parlamentare, ne votojmë për deputetët e Kuvendit të Republikës të Kosovës, të cilët janë 120 të cilët përfaqësojnë qytetarët e Kosovës.

Për të mësuar më shumë për zgjedhjet, ne si grup gazetarësh të vegjël, kemi dalur dhe kemi pyetur qytetarët: „Pse është e rëndësishme të dalim të votojmë në zgjedhje?“

Për fat të mirë, ne morëm shumë përgjigje nga ta. Njëri nga ta, Osman Kryeziu na tha se vota është e rëndësishme për zhvillimin e vendit dhe për të ardhmen e Kosovës. Kurse, Enver Sahiti na tha se ne duhet të dalim të votojmë, sepse vota jonë nuk duhet të keqpërdoret nga të tjerët.


Ne patëm kënaqësinë që të takojmë edhe një qytetar tjetër, i cili për rastësi ishte edhe shkrimtar i librave për fëmijë. Ai quhej Izet Hajdini.

Zotëri Hajdini na tha se vetëm personat, të cilët e meritojnë duhet të marrin votat dhe të tjerët nuk kanë të drejtë ta kundërshtojnë vendimin e popullit.

Sipas tij, personi që kandidon për të fituar votat e të tjerëve duhet të ketë aftësi, të jetë i zgjuar dhe të pëlqehet nga të tjerët.

Ne, edhe pse fëmijë, pajtohemi me të gjitha mendimet e qytetarëve dhe ju themi të gjithë juve që të dilni të votoni në të gjitha zgjedhjet që organizohen në shtetin tonë. Vetëm kështu mund të jetojmë të gjithë të lumtur dhe në harmoni.

Ju faleminderit që lexuat punën tonë dhe shpresojmë që keni mësuar edhe gjëra të reja. Për ne ishte kënaqësi shumë e madhe që ishim sot gazetarë!



Ne me shkrimtarin Izet Hajdini



Ekipi më i ri i gazetarëve



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Halil Alidema“  
Klasa: VI-2  
Vendi: Pozheran, Viti